# DËSHMI ARKIVI

**A-442643**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Migena Schroeder pastron paratë e aferave të AKSHI-it me kulla në Kosovë, Gerond Meçe i kaloi qindra mijëra euro ‘gjermanes’ në llogari. Lidhja korruptive e hajdutes me Daniel Shimën dhe Sokol Parllakun |
| ADRESA | https://prapaskena.com/2026/09/14/migena-schroeder-pastron-parate-e-aferave-te-akshi-it-me-kulla-ne-kosove-gerond-mece-i-kaloi-qindra-mijera-euro-gjermanes-ne-llogari-lidhja-korruptive-e-hajdutes-me-daniel-shimen-d-5/ |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 09:56:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 09:54:35 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | cab9e0adb8fcafaa0f185a8ac5fff6e8034039d22c2aee0a5d28cc97f52ea19a |
| TEKSTI | 0a47c5bd8fc8d25e67baf82f7f98e676a4845b7c96d39d762a229189a71e1116 |
| PAMJA | ad9d0535ccfb293b2ee49c893b84f61ba5cce99ed60552340e6f9947144b5a23 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | a6784568960fdbae3a2b8101c497b664468c7b5cd75049e408a586ddb2a6720d |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a6784568960fdbae3a2b8101c497b664468c7b5cd75049e408a586ddb2a6720d

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Migena Schroeder pastron paratë e aferave të AKSHI-it me kulla në Kosovë, Gerond Meçe i kaloi qindra mijëra euro 'gjermanes' në llogari. Lidhja korruptive e hajdutes me Daniel Shimën dhe Sokol Parllakun

Kryesore

Publikuar: 14/09/2026




Grupi kriminal i AKSHI-it, i cili ka zhvatur qindra milionë euro para publike, u nda vitin e fundit në dy fraksione rivale, rivalitet që solli ekspozimin dhe fundosjen e tij. Njëri fraksion përfaqësohej nga Ermal Beqiri, Mirlinda Karçanaj, Gys Agasi, Andis Papa etj., i goditur nga SPAK, ndërsa fraksioni tjetër përfaqësohej nga Gerond Meçe, Daniel Shima, Sokol Parllaku, Migena Shrëder (Schroeder) etj., i amnistuar deri më sot nga SPAK-u.

Fraksioni i dytë i korrupsionit, biznesmeni Gerond Meçe që ka përfituar 50 milionë euro tendera fiktivë dhe korruptivë, ish nëndrejtori i AKSHI-t Daniel Shima që po pastron paratë që ka ndarë me Gerond Meçen dhe biznesmenia Migena Shrëder, pjesë e rrjetit të Gerond Meçes dhe që pastron paratë e korrupsionit në kulla, ky fraksion e ka paraqitur veten si viktimë. Gerond Meçe i ABS dhe Daniel Shima paraqiten si viktima pengmarrje nga grupi tjetër Beqiri-Agasi, ndërsa Migena Shrëder si e shantazhuar nga Ermal Beqiri, e cili i kishte dhënë mesazhin mafioz; 'Ke hyrë në një pishinë me peshkaqenë'.

Faktet tregojnë se Migena Schroeder, e monitoruar duke bërë pazare tenderash, skema mashtrimi dhe pastrimi parash në 'Rogner', është pjesë korrupsionit me tendera dhe e skemës së pastrimit të parave të Gerond Meçes dhe Daniel Shimës. Migena

Me te lexuarat


Pacolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Benet Beqiri dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj


Emërimi i Yllka Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozit...


Pse Shqipëria nuk është më strehë e sigurt për paratë e "Çunave të Londrës", Daily Mail zbulon ko...

pastrimit të parave të Gerond Meçes dhe Daniel Shimës. Migena Schroeder është pronare e kompanisë "AESS Sh.P.K", kompani të cilën e ka kaluar 9 herë në emrin e babait të saj, 83-vjeçari, Lefter Klemo, sa herë ndiente rrezikun e veprimit të drejtësisë.

Migena Schroeder me kompaninë AESS shpk rezulton një nga linjat e pastrimit të parave të Gerond Meçes, i cili ka përfituar rreth 50 milionë euro nga AKSHI, duke ndarë një pjesë të parave me Daniel Shimës, përmes faturimeve fiktive mes ABS së Meçes dhe një rrjeti kompanish të kontrolluara nga Shima. Migena Schroeder me kompaninë AESS dhe kompania ABS Kosova e Gerond Meçes po ndërtojnë dy kulla në Prishtinë, duke pastruar miliona euro, produkt i skemës së korrupsionit me tenderat e AKSHI-t.

Migena Schroeder dhe Gerond Meçe përfaqësojnë një nga linjat më të fuqishme të pastrimit të parave në ndërtim në Kosovë, duke investuar miliona euro para të pista në kulla dhe komplekse vilash. Ky bashkëpunim në pastrimin e parave mes Migena Schroeder dhe Gerond Meçe i jep kuptim edhe dëshmisë së Migena Schroeder për SPAK, e cila goditi grupin rival të Meçes, atë të Ermal Beqirit, një hajdut po aq epik sa edhe Meçe.

Derivat i Gerond Meçes është edhe kompania Albascan, me pronar në letra Elision Jorgjis, të cilin ia kishin ofruar Migena Schroeder për të fituar tendera të paracaktuar në tavolinë. Albascan ka përfituar vetëm gjatë 5 viteve të fundit mbi 34 milionë euro tendera. Nga këto para, Albascan ka kaluar mbi 11 milionë euro me fatura fiktive tek kompania ABS e Gerond Meçes.

Nga ana tjetër, referuar librave të shitjes dhe blerjes së kompanive, Gerond Meçe përmes kompanisë së tij ABS ka kaluar qindra mijëra euro në llogaritë e kompanisë AESS të Migena Schroeder. Kjo e fundit rezulton një nga fijet e lëvizjes dhe pastrimit të parave të korrupsionit nga Gerond Meçe. AESS së Migena Schroeder dhe ABS e Gerond Meçes kanë të punësuar të njëjtët persoane. **Eneo Deliu** (ID: **J91012039M**) – del te **ABS** në **2023–2025** dhe te **AESS** në **2025**. **Kristi Sina** (ID: **K00803065Q**) – del te **ABS** në **2019–2025** dhe te **AESS** në **2025**. **Andi Canameti** (ID: **K10531053K**) – del te **ABS** në **2023–2025** dhe te **AESS** në **2025**.

Ndërkaq, në kontratën "laboratorët Smart 2", teksa ABS qëndroi në prapaskenë, në konsorcium u përfshinë kompanitë AEES, ALBASCAN e Elision Jorgjit, Sinteza Co dhe Synapse. Në këtë periudhë, konstatohen raporte financiare të AESS të Migena Schroeder me kompaninë 'ALU GLASS' të Sokol Parllakut, lavatriçen e pastrimit të parave të Daniel Shimës.

Parllaku i ka kaluar dhjetëra mijëra euro 'gjermanes' Migena Schroeder. Kujtojmë se Sokol Parllaku është prestanome dhe linja kryesore e Daniel Shimës për pastrimin e parave të korrupsionit

me tenderat e AKSHI-t në kulla, resorte, vila dhe biznese fiktive.
Faktet tregojnë se zonja Migena Schroeder nuk ka notuar mes 'peshkaqenëve' të korrupsionit, por është pjesë e 'vaskës' së korrupsionit dhe pastrirmit të parave.

TAG: ABS | ABS kosove | AESS shpk | AKSHI tendera | Gerond meçe | Kosovë | Migena shrëder | Pastrim parash

## Të ngjashme

**Kreu i FSDKSH Ilir Topi mashtron me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë, afera me depot farmacutike dhe farmacitë, mafia e ilaçeve vijon ske...**

**Lufta e padukshme e Kremlinit: nga kokat e derrave te ndërhyrjet në zgjedhje**

**Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj**


## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.





Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.